



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr.474/2023

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Mejreme Memaj dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të dënuarit V. I., nga P., lagjja "...", rruga "...", ..., për shkak të veprave penale vrasja e rëndë, parashikuar me nenin 179 par.1 nënpar.1.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), rrëmbimi, parashikuar me nenin 194 par.2 nënpar.2.3 lidhur me par.1 të KPRK dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 374 par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me kërkesën e mbrojtësit të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë, avokatit Besnik Berisha, të paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.80/2019 datë 18 mars 2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22 prill 2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit V. I., aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.80/2019 datë 18.03.2022 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.271/2022 datë 20 prill 2023 ndryshohet vetëm sa i përket cilësimit juridik të veprës penale të vrasjes së rëndë dhe vendimit për dënimin, ashtu që Gjykata e Supreme e Kosovës gjen se, në veprimet e të dënuarit V. I. të përshkuara nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë formohen elementet e veprës penale vrasje, parashikuar me nenin 178 të KPRK, dhe për këtë vepër e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) vitve, ndërsa duke ia marrë si të vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) viteve për veprën penale të rrëmbimit, parashikuar me nenin 194 par.2 nënpar.2.3 lidhur me par.1 të KPRK dhe një (1) vit e gjashtë (6) muaj të shqiptuar për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, konform dispozitës së nenit 76 par.2 pika 2.2. të KPRK i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej njëzet e dy (22) viteve, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 4 shtator 2019 e tutje.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.80/2019 datë 18 mars 2022, të pandehurin V. I., e ka shpall fajtor për veprat penale vrasje e rëndë, parashikuar me nenin 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK, rrëmbimi, parashikuar me nenin 194 par.2 nënpar.2.3 lidhur me par.1 të KPRK dhe mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, dhe pasi që ia ka caktuar dënimin me burgim për secilën vepër dhe atë: për vrasje të rëndë dënimin me njëzet e një (21) vjet burgim, për rrëmbim tri (3) vite burgim dhe një vit e gjashtë ( 1 vit e 6 ) muaj burgim për armëmbajtje pa leje, konform dispozitës së nenit 76 të KPRK e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej njëzet e pesë (25) viteve, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 4.09.2028 e tutje.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.271/2022 datë 20 prill 2023 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit, kurse e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit avokati Besnik Berisha, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar, kurse aktgjykimet e kundërshtuara sa i përket veprës penale të vrasjes së rëndë të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Ndaj kërkesës së mbrojtësit është përgjigjur Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.284/2023 datë 18 shtator 2023, me propozim që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është pjesërisht e bazuar.

a) Vlerësimi i kësaj Gjykate përkitazi me pretendimet e mbrojtësit në kërkesë sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal

Mbrojtësi në kërkesë pretendon se aktgjykimi gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, parashikuar me nenin 384 par.2 nënpar.2.1, 2.2 dhe 2.7 lidhur me nenet 3.2, 7, 9.1, 148, 360.2, 364.1, 369.4, 369.7 dhe 404.1 të KPP për shkak se:

- janë dhënë arsye të paqëndrueshme, të pasakta, kontradiktore dhe të pamjaftueshme lidhur me rrezikimin konkret të jetës së kinse të dëmtuarit B. B.. Sipas mbrojtjes në rastin konkret nuk përmbushet asnjëri nga elementet që karakterizojnë rrezikshmërinë konkrete si rrethanë cilësuese e veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 nënpar.1.5 të KPRK, jo vetëm pse me veprimet e të dënuarit nuk është krijuar rrezikshmëri konkrete për jetën e kinse të dëmtuarit, por edhe për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka konstatuar ekzistimin e dashjes se të dënuarit për ta rrezikuar jetën e tij. Dëshmitari B. B. në dëshminë e tij ka sqaruar vendndodhjen e tij në momentin e gjuajtjes së parë, dhe se në momentin fillestar tashmë i ndjeri gjendej afër banakut në këmbë me duart e vendosura mbi banak, tri metra përballë të dënuarit, ndërsa, dëshmitari gjendej tek dera e kuzhinës dy metra larg viktimës, prapa, në krahun e majtë. Gjykata e shkallës së parë konstaton se i dënuari ka gjuajtur një herë me revole në drejtim të tani të ndjerit I. S. dhe se dëshmitari B. menjëherë pas gjuajtjes së parë ka vepruar në brendi të kuzhinës. Të shtënat kanë qenë në kënd të drejtë me të ndjerin dhe pas të shtënës së parë siç ka theksuar dëshmitari, menjëherë ka ikur nga dera e pasme e kuzhinës sepse është rrezikuar dhe frikësuar. Gjykata konsideron se i njëjti duke qenë shumë afër tani të ndjerit ka qenë seriozisht i rrezikuar nga i dënuari, i cili siç thotë ka shtënë me armë në dorë në tani të ndjerin në distancë prej 2-3 metra e që në realitet i është rrezikuar jeta edhe dëshmitarit B. edhe përkundër faktit se të shtënat kanë qenë në drejtim të I. S., duke marrë parasysh afërsinë që e ka pasur me të ndjerin dhe pas të shtënës së parë nga frika duke qenë i rrezikuar ka ikur nga bufeja nga dera e pasme e kuzhinës. Kurse, gjykata e shkallës së dytë sipas mbrojtësit për ta rënduar me çdo kusht pozitën e të ndjerit sajton rrezikshmërinë për jetën e kinse të dëmtuarit, i cili ishte jashtë rrezes së veprimit të armës dhe në distancë të konsiderueshme nga viktimat. Sipas asaj gjykate “në rastin konkret, nuk është kontestuese se i akuzuari ka shtënë në drejtim të ndjerit në kënd të drejtë, siç deklaroi edhe B. B., mirëpo, marrë parasysh gjurmët në vendin e ngjarjes dhe sidomos shenjen në mur shumë afër derës ku ishte i dëmtuari, rezulton se ka ekzistuar rreziku konkret edhe për këtë të dëmtuar, pa marrë parasysh se ekspertët konstatojnë se është vrimë nga plumbi i rikoshetuar në mur, që vërteton faktin se i akuzuari nuk ka vepruar me dashje direkte në drejtim të rrezikimit të jetës të dëmtuarit B.”. Sipas mbrojtësit gjykata e shkallës së dytë e përjashton dashjen direkte, e kjo ndikon drejtpërdrejt në tiparet esenciale të veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK. Përveç kësaj, sipas mbrojtësit konkludimi i gjykatës së shkallës së dytë se vrima në mur është shkaktuar nga predha e rikoshetuar është fakt i sajuar dhe nuk mbështetet në shkresa të lëndës respektivisht provat e administruara, ngase ekspertët e balistikës kanë konstatuar se gëzhojat pas shkrepijes kanë goditur në mur dhe kanë rikoshetuar, kurse sipas mbrojtjes gëzhoja e rikoshetuar nuk përbën asnjë rrezikshmëri konkrete për jetën e kinse të dëmtuarit. Pastaj, edhe nën prezumimin se bëhet fjalë për vrimë të shkaktuar nga predha mbetet

tërësisht e panjohur dhe e pasqaruar se a bëhet fjalë për predhën e parë apo të dytë, si rrethanë vendimtare që përcakton rrezikshmërinë konkrete, sepse siç del nga deklaratat e dëshmitarit menjëherë pas shkrepjes së parë ai ka dal në kuzhinë, pra, nuk ka qenë fizikisht i pranishëm në momentin e gjuajtjes së predhës së dytë. Në anën tjetër arma siç konstatohet edhe nga ekspertët e balistikës pistoleta "..., e kalibrin ... mm, me të cilën është privuar nga jeta i ndjeri gjuan në mënyrë gjysmë automatike, çka përjashton rrezikshmërinë konkrete për shkak se gjuajtjet janë manualisht të kontrolluara;

- gjatë shqyrtimit në gjykatën e shkallës së dytë në mënyrë të kundërligjshëm janë refuzuar propozimet e mbrojtjes të cilat do të kontribuonin në sqarimin e detajuar të gjendjes mendore dhe aftësive volitive të dënuarit. Kështu, në këtë drejtim mbrojtësi ka propozuar që të administrohen si provë procesverbali i psikologes M. C. datë 1.09.2022, si dhe testi i ... datë 12.06.2017 të cilat ishin me rëndësi për objektin e ekspertimit të ekspertëve psikiatër A. B. dhe A. V., e po ashtu kishte propozuar që deklaratat e dëshmitarëve tu dërgoheshin eksperteve meqë me rastin e ekspertimit nuk kishin disponuar me to, por gjykata e shkallës së dytë kishte refuzuar këto propozime, e që sipas mbrojtësit hapja e shqyrtimit gjyqësor në shkallë të dytë ishte bërë vetëm sa për ta evituar kthimin e çështjes në rigjykim, e jo për t'i shërbyer vërtetimit të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike;

- nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme, të sakta lidhur me pretendimet ankimore mbi ndryshimin e identitetit të aktakuzës. Me akuzë përkitazi me veprën penale vrasje e rëndë -nën pikën I të dispozitivit të akuzës prokuroria e ngarkon të dënuarin se ka rrezikuar jetën e të dëmtuarës F. B. ( mbrojtësi citon dispozitivin e akuzës), gjykata e shkallës së parë e ndryshon personin e rrezikuar, ashtu që në vend të F. B. tani rrezikohet i dëmtuari/dëshmitari B. B.. Në fakt ndryshimi i përshkrimit faktik nga ana e gjykatës në fazën e përpilimit të aktgjykimit nga shkalla e parë i ka pamundësuar të dënuarit që të paraqes mbrojtjen e tij në raport me faktet e reja inkriminuese çka ka cenuar të drejtën e tij për mbrojtje si shtyllë esenciale mbi të cilën mbështetet e drejta kushtetuese për gjykim të drejtë;

- nuk janë dhënë arsye të sakta precize përkitazi me motivin e vrasjes së të ndjerit. Në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë që vërtetohet nga gjykata e shkallës së dytë theksohet se i dënuari me dashje ka privuar nga jeta të ndjerin, pa precizuar se cili ishte motivi i këtij akti, dhe në rastin konkret gjendemi para një vrasje pa motiv, çka konfirmon teorinë e mbrojtjes së i dënuari vuante nga një çrregullim mendor serioz, i cili prekte sferën e të menduarit dhe të perceptuarit, ku për rrjedhojë ditën kritike kishte pësuar një traumë të fortë, e cila e bëri që të kryente një veprim të padëshiruar dhe të pakontrolluar;

- gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye të qarta përkitazi me pretendimet ankimore se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i paqartë në raport me përcaktimin e motivit të vrasjes, përcaktimin e rrezikshmërisë konkrete për jetën e kinse të dëmtuarit B. B., me

përcaktimin e vendndodhjes së saktë të kinse të dëmtuarit në momentin e shkrepsjes së parë të armës, kurse arsyet e dhëna se ky lloj i vrasjes, elementi cilësues, sistemohet sipas mënyrës së kryerjes e jo sipas motivit është në kundërshtim me vet praktikën gjyqësore të asaj gjykate;

- janë dhënë arsye të paqarta, të paqëndrueshme dhe të pasakta lidhur me pretendimet mbi papranueshmërinë e provave të siguruara gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes. Sipas mbrojtjes aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale nga neni 384 par.1 nënpar.1.8 lidhur me nenet 150.2 dhe 257.2 të KPP, sepse aktgjykimi është mbështetur mbi dëshmitë (raporti i balistikës) e siguruara gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes gjatë së cilës nuk ka marrë pjesë avokati mbrojtës. Lidhur me këtë gjykata e shkallës së dytë vlerëson se raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i referohet veprimeve hetimore policore të ndërmarra në pajtim me nenin 70 të KPP dhe ky raport nuk ka të bejë fare me këqyrjen dhe rikonsruimin e vendit të ngjarjes sipas nenit 150 të KPP, mirëpo, një vlerësim i tillë është i paqëndrueshëm sepse ky raport është përpiluar konform dispozitës së nenit 150.1 të KPP, dhe pavarësisht kësaj edhe po të behej fjalë për raport të veprimeve fillestare të policë, siç pretendon shkalla e dytë serish vlejné kufizimet nga neni 150.8 të KPP lidhur me pranueshmërinë e provave.

Sipas mbrojtësit shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të bëra nga shkalla e dytë ngërthejnë në vete të njëjtat shkelje që janë bërë nga gjykata e shkallës së parë, e që shkeljet e lartcekura, vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike kanë rezultuar me shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarit, nga neni 385 par.1 nënpar.1.1 i KPP sepse nuk është provuar përgjegjësia e tij penale në raport me aftësinë e tij mendore në momentin e kryerjes së veprës penale, si dhe rrezikshmëria konkrete për jetën e dëshmitarit B. B. si elemente kyçe të cilat përbëjnë figurën e veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK për të cilën është shpall fajtor dhe dënuar.

Vlen të theksohet se pretendimet e mbrojtësit përkitazi me bazën ligjore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale janë ngushtë të ndërlidhura me bazën ankimore - vërtetimi i gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (për të cilën bazë kërkesa nuk mund të ushtrohet – neni 432 i KPP) ngase kontestohen konkludimet e gjykatave në bazë të provave të administruara, por meqë ndërlidhen edhe me aplikimin e ligjit penal, kjo Gjykatë i shqyrtoj ato dhe gjeti se janë të pabazuara.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i shkallës së parë i cili është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në kërkesë. Në fakt gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të aktgjykimit në mënyrë konkrete dhe të qartë ka theksuar kohën, vendin, shkakun dhe mënyrën se si i dënuari V. I. e ka privuar nga jeta të ndjerin I. S.. Ndërsa, meqë, me akuzë i dënuari është akuzuar për veprën penale të vrasjes së rëndë, 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK, për të cilën edhe është shpall fajtor, pa bazë pretendohet në kërkesë se dispozitivi i aktgjykimit sa i përket motivit të veprës penale është i

paqartë, ngase motivi i veprës penale nuk është element cilësues i veprës penale, dhe arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së dytë si të drejta i vlerëson edhe kjo gjykatë. Kurse, është evidente se në këtë çështje juridiko penale gjykata e shkallës së dytë ka hapur shqyrtim dhe ka dëgjuar ekspertët e ekspertizës psikiatrike te forenzikës A. B. dhe A. V. përkitazi me konkludimin e tyre përkitazi me aftësinë mendore të të dënuarit në kohën e kryerjes së veprës penale të cilët në seancë e kanë mbështetur konkludimin e tyre, dhe në këtë seancë gjykata e shkallës së dytë ka refuzuar propozimin e mbrojtësit që të administrohen si provë procesverbali i psikologes M. C. datë 1.09.202, si dhe testi i ... datë 12.06.201, mirëpo, refuzimi i një propozimi konkret të palëve qofte për administrimin e një prove apo ndërmarrjen e ndonjë veprimi procedural nuk ka të bëjë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale aq me tepër kur gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsye të qarta se pse ka refuzuar propozimin e mbrojtjes, të cilat arsye i mbështet edhe kjo gjykatë. Gjykatat në pajtim me dispozitën e nenit 370 të KPP kanë paraqitur arsye për çdo pikë të aktgjykimit, kanë vlerësuar provat e administruara si ato materiale dhe jo materiale, dëshmitë e dëshmitareve dhe ekspertizën mbi gjendjen mendore të të dënuarit dhe kanë dhënë arsye se pse ia kanë falur besimin ekspertizës psikiatrike mbi gjendjen mendore të të dënuarit në kohën e kryerjes së veprës penale. Eksperte janë persona profesional që thirren në procedurë penale që të japin konstatimin dhe mendimin për faktet kontestuese konkrete. Ndërsa, gjykata nuk është e lidhur me konstatimin dhe mendimin e ekspertit, gjithnjë përderisa nuk e pranon si zgjidhje objektive e reale të çështjes së caktuar penale. Në rastin konkret ekspertiza psikiatrike është bërë me kërkesë të mbrojtësit, kurse sipas vlerësimit të këtij kolegji konstatimet dhe mendimet e grupit prej katër eksperteve të ekspertizës psikiatrike janë në harmoni me parimet shkencore, përvojën e tyre profesionale, pra, mendimin dhe konstatimin e tyre se i dënuari në kohën e kryerjes së veprës penale kishte aftësi intelektuale apo volative, gjegjësisht zvogëlim të aftësisë për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve të tij, e cila nuk ishte esenciale, kjo gjykatë e konsideron si zgjidhje objektive të çështjes. Pra, sipas kësaj ekspertize, përgjegjshmëria e të dënuarit në kohën e kryerjes së veprës penale ishte e zvogëluar, por jo aq sa ai të mos ishte në gjendje t'i kuptonte veprimet e tij apo ta kuptonte veprën penale, dhe aftësia e tij mendore madje nuk ishte as esencialisht e zvogëluar, prandaj pa bazë pretendohet në kërkesë se nuk është provuar përgjegjësia e tij penale në raport me aftësinë mendore në momentin e kryerjes së veprës penale.

Të pabazuara janë edhe pretendimet se aktgjykimet mbështeten në prova të papranueshme që i referohet raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes sipas të cilit është bërë edhe ekspertiza balistike. Kjo për faktin se nuk kemi të bëjmë me raport të këqyrjes së vendit të ngjarjes konform nenit 150 të KPP ashtu siç pretendon mbrojtësi dhe as që ky raport thirret në këtë nen. Në fakt kemi të bëjmë me veprime të policisë të ndërmarra konform dispozitës së nenit 70 të KPP, që sipas këtij neni policia ka autorizim që të zbulojë, mbledhë dhe ruajë gjurmët dhe provat nga vendi i ngjarjes për veprën penale të dyshuar. Kurse, sipas par.7 te nenit 150 të KPP dispozitat nga ky nen nuk prejudikojnë kompetencat e policisë për të ndërmarrë hapa fillestarë në mbledhjen e informatave, për të bërë matje, incizime, skica dhe për të mbledhur prova mjeko ligjore nga nenet 70-77 të kodit.

Ndërkaq, konkludimet e gjykatave përkitazi me veprën penale të vrasjes së rëndë, për të cilën i dënuari V. I. është shpall fajtor dhe dënuar në raport me gjendjen faktike të vërtetuar sipas

vlerësimit të kësaj gjykate janë të gabuara, konkludime këto që i përkasin zbatimit të ligjit penal për çka në këtë drejtim do të behet fjalë në vijim.

Në të vërtetë, në kontekst të vlerësimit të provave të administruara në këtë çështje juridiko penale kjo gjykatë i vlerësoj veprimet e të dënuarit në raport me të ndjerin I. S. dhe të dëmtuarin B. B. jeta e të cilit është rrezikuar sipas konkludimit të gjykatave. I dënuari është gjykuar për veprën penale vrasja e rëndë, parashikuar me nenin 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK, por, këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë, kjo gjykatë nuk e vlerëson si të drejtë, për këto arsye:

Për ekzistimin e veprës penale të vrasjes së rëndë, parashikuar me nenin 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK, është e nevojshme që krahas vrasjes së një personi, të shkaktohet rrezik konkret për jetën e së paku një personi, por, të kryesi duhet të ekzistojë dashja lidhur me veprën penale të vrasjes, si dhe lidhur me shkaktimin e rrezikut konkret për jetën edhe të ndonjë personi tjetër.

Fillimisht vlen të theksohet se i dënuari është akuzuar për tri vepra penale atë vrasjes së rëndë siç u cek me lartë, veprën penale të rrëmbimit dhe të armëmbajtjes pa lejë. Për veprën penale të rrëmbimit dhe të armëmbajtjes pa leje i dënuari e ka pranuar fajësinë dhe këto vepra nuk kundërshtohen as me kërkesë. Në fakt as më kërkesë nuk kontestohet vrasja e të ndjerit nga i dënuari, por kontestuese dhe çështje për vlerësim janë pretendimet në kërkesë sa i përket përgjegjësisë penale respektivisht aftësisë mendore të të dënuarit në kohën e kryerje së veprës penale, dhe elementi cilësues i vrasjes. Përkitazi me aftësinë mendore të të dënuarit në kohën e kryerjes së veprës penale është bërë fjalë në kuadër të shkeljeve esenciale dhe nuk do të bëhen vlerësime edhe njëherë.

Pastaj, siç del nga përshkrimi i veprimeve inkriminuese të të dënuarit në dispozitiv të akuzës sa i përket veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 nënpar.1.5 të KPK i dënuari e ka privuar nga jeta të ndjerin I. S. dhe me dashje e ka vënë në rrezik jetën e të dëmtuarës F. B., dhe në dispozitiv të akuzës ndër të tjera theksohet:

“.. ka privuar nga jeta tani të ndjerin I. S. duke e rrezikuar edhe jetën e tani të dëmtuarës F. B. në atë mënyrë që derisa i ndjeri ishte në vendin e tij të punës si menaxher kuzhine, në kuzhinë ka shkuar i pandehuri me revole në dorë të tipit ..., kal....mm, e therret në emër “I.”, i ndjeri i përgjigjet urdhno xhaxh, pandehuri menjëherë shtënë dy herë me revole në distancë prej rreth 3 metra e godet në pjesën e majtë të gjoksit dhe i shkakton plagë vdekjeprurëse, e me pastaj me revole në **dore del në oborr**, i ofrohet të dëmtuarës F. B., ja vendos revolen në kokë e dërgon deri të vetura që ndodhej në parkingun e agjencisë..”.

Nga ky dispozitiv i akuzës rezulton se përshkrimi faktik i veprimeve inkriminuese të të dënuarit nuk i përgjigjet emërtimit ligjor të veprës penale - vrasjes së rëndë me rrezikim të jetës së

personit tjetër për shkak se rrezikimi i jetës së personit tjetër nuk i atribuohet veprimeve të dënuarit të ndërmarra me rastin e të shtënave në të ndjerin, por veprimeve të ndërmarra pas të shtënave në të ndjerin, pra, pasi që e vret të ndjerin, e për të cilat veprime i dënuari është akuzuar për vepër penale të posaçme atë të rrëmbimit. Pra, nga ky përshkrim nuk rezulton se i dënuari me rastin e privimit nga jeta të të ndjerit ka vënë në rrezik konkret jetën e të dëmtuarës F. si element cilësues që lypset për tu konsumuar kjo vepër penale.

Rezulton se aktakuza përkitazi me këtë vepër penale ka kaluar në këtë formë ngase është konfirmuar dhe çështja ka kaluar në shqyrtimin gjyqësor.

Në këtë çështje siç del nga provat e administruar i vetmi dëshmitar okular i ngjarjes ishte dëshmitari B. B. i cili me akuzë është propozuar që të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit, por, dëshmia e tij është marrë vetëm në polici. Në polici nder të tjera ky dëshmitar ka deklaruar se *“posa ka hyrë në restorant e kam vërejtur se V. e ka pasur një armë në dorë dhe duke ardhur në drejtim tonin e kam dëgjuar se ka thenë “I.”, kurse i ndjeri ia ka kthyer përgjigjen me fjalët “urdhno xhaxh”, pas këtyre fjalëve V. e ka drejtuar armën në drejtim të ndjerit dhe në një distancë prej 3 metrave ka shtënë së paku një herë (aq të shtëna ka dëgjuar). Pas të shtënës së armës ka qenë i sigurt se V. e ka goditur të ndjerin kështu që menjëherë ka ikur nga dera e kuzhinës dhe ka dal jashtë ndërtesës. Në kohën kur ka ndodh incidenti ka qenë vetëm ai, kolegu I. S. dhe punëtori i sigurimit V. I. Në momentin kur V. ka ardh në restorant dhe ka shtënë me armë, ka qenë **brenda në kuzhinë**, por e ka parë ngjarjen sepse dera e kuzhinës ka qenë e hapur, kurse kolegu I. ka qenë rreth dy metra para tij dhe ishte pikërisht i mbështetur në shankun e restorantit”*. Pra, dëshminë e këtij dëshmitar e ka pas në dispozicion prokuroria, i cili nuk është dëgjuar në prokurori, kurse është propozuar që të dëgjohet në shqyrtimin gjyqësor.

Kurse, pas dëgjimit të tij në shqyrtimin gjyqësor gjykata e shkallës së parë ka urdhëruar rikonstruimin e vendit të ngjarjes. Në vendin e ngjarjes përveç dy gëzhjave dhe dy predhave janë evidentuar edhe një vrimë në xham të dritares afër banakut, që ishte në anën e majtë shikuar nga restoranti në drejtim të banakut dhe një vrimë në muri mbrapa banakut në anën e majtë të derës shikuar nga restoranti në drejtim të banakut, në një lartësi nga dysHEMEJA rreth 90 cm. Pas rikonstruimit të vendit të ngjarjes sipas ekspertit mjeko ligjor i cili e ka bërë autopsinë i ndjeri është goditur dy herë me armë zjarri në kafazin e kraharorit dhe kishte pësuar katër plagë ( dy plagë hyrëse dhe dy dalëse) nga përshkrimi i dy predhave që korrospodojnë me dy gëzhjat dhe dy predhat e gjetura në vendin e ngjarjes, ndërsa në bazë të karakteristikave të plagëve rezulton se distanca nga tyta tek plaga **ishte mbi një metër**. Kurse, ekspertët e balistikës kanë deklaruar se “ bazuar në pozitën ku janë gjetur gëzhjat në vendin e ngjarjes dhe duke i krahasuar ato me mostrën standarde të hedhjes së gëzhjave nga arma “...” nënkupton se gëzhjat pas shkrepjes kanë goditur në muri dhe janë rikoshetuar dhe është e pamundur të përcaktohet as për së afërmi distanca nga gryka e armës deri të viktima. Meqë, arma “...” i hedh gëzhjat në anën e djathtë të gjuajtësit në kënd prej 150 deri 161 shkallë në drejtimin e gjuajtjes dhe në distancë prej 2.8 deri



në 7.9 metra nënkupton se gjuajtësi duhet të ketë qenë në kthesën e objektit ku gjendet banaku dhe gëzhojat duhet të kenë goditur murin e anës së djathtë të kthinës ku gjendej banaku dhe të jenë rikoshetuar me pastaj. Një opsion tjetër për të shpjeguar pozitën ku janë fiksuar gëzhojat në vendin e ngjarjes mund të jetë që gëzhojat të jenë goditur nga personat gjatë lëvizjes nëpër kafenenë apo restorantin ku ka ndodhur ngjarja dhe të kenë përfunduar në pozitat e fiksuara. Po ashtu bazuar edhe pozitën ku viktimja i ka marrë plagët në raport me dëmtimet e shkaktuara në murin pas banakut dhe xhamat e anës së majtë të kthinës ku gjendet banaku mund të përfundohet se distanca në mes të viktimës dhe grykës së armës të ketë qenë diku rreth tre apo katër metra e që tregon mungesën e faktorëve plotësuese të qitjes të cilët nuk janë vërejtur gjatë autopsisë”. Sipas video incizimeve të rikonstruimit të vendit të ngjarjes del se gjuajtja në drejtim të ndjerit është bërë në kënd të drejtë, i ndjeri ka qenë afër banakut në këmbë, me duart e vendosura mbi banak, kurse dëshmitari ka qenë në derë të kuzhinës dy metra larg viktimës prapa në krahun e tij të majtë.

Pas administrimit të provave në këtë çështje rezulton se prokurori ka mbet pranë akuzës së ngritur, kurse gjykata e shkallës së parë e shpall fajtor të dënuarin për veprën penale të vrasjes së rëndë, parashikuar me nenin 179 par.1 nënpar.1.5 të KPRK, por jo se ka rrezikuar jetën e të dëmtuarës F. B. siç theksohet në akuzë, por jetën e dëshmitarit B. B.. Bazuar në dëshminë e dëshmitarit ( i cili ka deklaruar se ka qenë në derën e kuzhinës, i ndjeri ka qenë në afërsi të banakut në këmbë me duar përmbi banak) dhe rikonstruimin e vendit të ngjarjes gjykata e shkallës së parë konkludon se *“të shtënat kanë qenë në kënd të drejtë në raport me të ndjerin dhe pas të shtënës së parë siç ka theksuar dëshmitari menjëherë ka ikur nga dera e pasme e kuzhinës sepse është rrezikuar dhe frikësuar. Këtë pozicion e ka përshkruar edhe me rastin e rikonstruimit të vendit të ngjarjes. Gjykata konsideron se i njëjti duke qenë shumë afër të ndjerit ka qenë seriozisht i rrezikuar nga tani i dënuari, i cili siç thotë dëshmitari ka shtënë me armë në dorë në tani të ndjerin në distancë 2-3 metra, e që në realitet i është rrezikuar jeta edhe dëshmitarit B. edhe përkundër faktit se të shtënat kanë qenë të drejtuara në drejtim të ndjerit, duke marrë parasysh afërsinë që ka pasme të ndjerin dhe pas të shtënës së parë nga frika duke qenë i rrezikuar, ka ikur nga bufeja nga dera e pasme e kuzhinës”*. Kurse, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se *“konkludimi i shkallës së parë se me veprimet e të dënuarit është rrezikuar jeta e B. B. janë të drejta. Mirëpo, duke pasur parasysh se si është zhvilluar ngjarja, kjo gjykatë vlerëson se i akuzuari në drejtim të dëmtuarit B. nuk ka vepruar me dashje direkte siç gabimisht ka gjetur shkalla e parë, por me dashje eventuale pasi që ishte i vetëdijshëm se nga veprimi i tij mund të rrezikohet edhe jeta e personit që ishte afër të ndjerit dhe ai e pranon shkaktimin e pasojës edhe për të. Në rastin konkret nuk është kontestuese se i akuzuari ka shtënë në drejtim të ndjerit në kënd të drejtë, si deklaroi edhe B. B., mirëpo, marr parasysh gjurmët në vendin e ngjarjes dhe sidomos shenjën në mur shumë afër derës ku ishte i dëmtuari B., rezulton se ka ekzistuar rreziku konkret edhe për këtë të dëmtuar pa marrë parasysh se ekspertët konstatojnë se është vrëmë nga plumbi i rikoshetuar në mur që vërteton faktin se i akuzuari nuk ka vepruar me dashje direkte në drejtim të jetës së të dëmtuarit B.”*

Pavarësisht përshkrimin faktik në dispozitiv të akuzës sa i përket elementit cilësues të veprës penale të vrasjes së rëndë dhe ndryshimeve të bëra nga gjykata pas administrimit të provave, kjo gjykatë bazuar në gjendjen e fakteve të lartcekura veçanërisht videoincizimin e rekonstruimit të vendit të ngjarjes dhe dëshmisë së dëshmitarit B. vlerëson se dashja e të dënuarit ishte që ta privoj nga jetë të ndjerin, por jo edhe ta rrezikoj jetën e dëshmitarit B. B., pra kjo gjykatë konkludimet e gjykatave përkitazi me elementin cilësues të vrasjes – shkaktimin e rrezikut konkret për jetën e së paku një personi, i vlerëson si të paqëndrueshme në raport me provat e administruara.

Nëse kihet parasysh se në të ndjerin është shtënë me armë *në kënd të drejtë në një afërsi prej 2-3 metrave*, dhe është goditur me dy predha në kafazin e kraharorit, duke pësuar katër plagë ( dy plagë hyrëse dhe dy dalëse) nga përshkrimi i dy predhave që korrospodojnë me dy gëzhojat dhe dy predhat e gjetura në vendin e ngjarjes, dhe derisa ishte në pozitë të qëndrimit në këmbë me duar mbi banak, pozitën e dëshmitarit dy metra larg të ndjerit (prapa në krah të majtë) tek dera e kuzhinës imponohet pyetja se a është e mundur që në një situatë të tillë të njëjtat predha që e kanë goditur tani të ndjerin pas depërtimit nga trupi i tij t'a rrezikojnë edhe jetën e dëshmitarit B. B. i cili ishte tek dera e kuzhinës. Bazuar në pozitën e të ndjerit, pozitën nga ku ka gjuajtur i dënuari, llojin e armës (gjysmë automatike), numrin e të shtënave, por edhe dëshminë e dëshmitarit i cili deklaroi se pas të shtënës së parë ka ikur dhe nuk ka dëgjuar të shtëna tjera, kjo gjykatë vlerëson se me të shtënat në drejtim të ndjerit nuk ka pas mundësi konkrete apo të afërta që të rrezikohet jeta e dëshmitarit B. B., kurse duke pas parasysh se vrma në mur sipas eksperteve të balistikës është rezultat i gëzhojave që pas shkrepjes kanë goditur në muri dhe janë rikoshetuar, kjo gjykatë konkludimet e gjykatave se ka ekzistua rreziku konkret edhe për jetën e dëshmitarit B. i vlerëson tërësisht si të pabazuara dhe pa mbështetje në prova të administruara, siç me të drejtë pretendohet në kërkesë, prandaj kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë vetëm elementet e veprës penale të vrasjes, nga neni 178 të KPRK.

Ndërsa, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i kanë vlerësuar gjykatat me rastin e matjes së dënimit veçanërisht faktin se vepra penale është ricilësuar në një vepër penale dukshëm me të butë, kjo gjykatë të dënuarit për veprën penale të ricilësuar i shqiptoj dënimin me burgim në kohëzgjatje prej ... viteve, ndërsa duke ia marrë si të vërtetuar dënimin me burgim për veprën penale të rrëmbimit dhe të armëmbajtjes pa leje, konform dispozitave ligjore i shqiptoj dënim unik me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale dhe përgjegjësinë penale të tij, dhe se me të do të mund të ndikohet në parandalimin e tij nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij, por edhe në parandalimin e të tjerëve nga kryerja e veprave penale, respektivisht do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK.

Nga sa u tha me lartë e konform dispozitës së nenit 438 par.1 pika 1.1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË  
Pml.nr.474/2023, me 22 prill 2024

Procesmbajtësja,  
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetari i kolegjit,  
Agim Maliqi